VENDIM
Nr. 186, datë 16.11.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HEC ZALL XHUXHË" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e"; nenit 10, pika 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.11.2020, mbasi shqyrtoi dhe relacionin nr. 119/3 prot., datë 11.11.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Hec Zall Xhuxhë" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Hec Zall Xhuxhë" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1165 prot., datë 3.11.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria "Hec Zall Xhuxhë" sh.p.k., është regjistruar në QKB në datën 1.10.2013, dhe mban statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.).
- Në objekt të veprimtarisë së saj shoqëria "Hec Zall Xhuxhë" sh.p.k. ka: Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve "Zall Xhuxhë 1" dhe "Zall Xhuxhë 2", tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike, në zbatim të kontratës së koncesionit të formës BOT të lidhur me datë 9.9.2013, me nr. 10329 rep., nr. 3323 kol.
- Aplikimi i shoqërisë "Hec Zall Xhuxhë" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, si më poshtë:
- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c") është plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d" "e", "f" dhe "g") është plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d") është plotësuar pjesërisht;
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8, germat: "a", "b", "c", "d") është plotësuar pjesërisht.

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar nga aplikanti, si më poshtë:

Neni 9, pika 1: Aplikimi është paraqitur në formatin fotokopje, ndaj, në zbatim të nenit 8, pika 3, të rregullores, shoqëria duhet ta depozitojë atë në origjinal ose fotokopje të noterizuar/njësuar me origjinalin.

Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor:

- Germat: "a", "b" (akti i themelimit/statuti nëse është hartuar si dokument i ndryshëm/ i veçantë nga akti i themelimit). Plotësuar pjesërisht.
- Germa "d" (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria). Pa plotësuar.
- Germa "e" (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse). Pa plotësuar.

Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- Germa "a" (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave). Pa plotësuar.

- Germa "b" (paraqitje bilanci financiar të tri viteve të fundit). Shoqëria duhet të depozitojë pasqyrat financiare për vitin 2019.

- Germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Pa plotësuar.

- Neni 9, pika 4.8. Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike:

- Germa "a": sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t'u tregtuar në GWh sipas viteve. Pa plotësuar.

- Germa "b". kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj. Pa plotësuar.

- Germa "c". Lista e kontratave të mëparshme të realizuara (nëse ka pasur). Pa plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Hec Zall Xhuxhë" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti